

POLITIKA PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NË NJË GJUHË TË AFËRT ME FËMIJËT

MBROJTJA E FËMIJËVE ËSHTË NJË DETYRIM PËR SECILIN PREJ NESH!



Të dashur miq,

Të gjithë tashmë keni dëgjuar për Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijës, e cila ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të të gjithë fëmijëve në botë.

Organizata SOS Fshati i Fëmijëve, e frymëzuar nga ky dokument, si dhe nga qëllimet dhe vlerat e saja, kurse me dëshirë që fëmijëve për të cilët kujdeset në fshatrat e saja, t'u sigurojë ambient të kujdesshëm dhe të sigurt në komunitetet, e krijoi dokumentin e ashtuquajtur Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Ky dokument është shumë i rëndësishëm për organizatën tonë - si për të rriturit të cilët duhet t'i mbrojnë fëmijët nga të gjitha format e abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit dhe pabarazisë, ashtu edhe për ju - fëmijët, që të dini se cilat veprime ndaj jush nuk janë të lejuara, çka bëjmë për t'i parandaluar dhe çfarë ndërmerret nëse prapëseprapë ndodh ndonjë abuzim. Politika për mbrojtjen e fëmijëve të SOS Fshatit të Fëmijëve thotë qartë:

AS NJË LLOJ ABUZIMI DHE NEGLIZHENCË NDAJ FËMIJËVE
NUK DUHET LEJUAR! MBROJTJA E FËMIJËVE ËSHTË NJË
DETYRIM PËR SECILIN PREJ NESH!

Në këtë dokument do të kuptoni:

- çfarë është "abuzim" dhe çfarë është "neglizhencë" e fëmijëve;
- abuzim mund të ndodhë edhe ndërmjet fëmijëve dhe kjo gjithashtu nuk lejohet;
- çfarë është "privatësia" dhe pse kujdesemi për privatësinë e fëmijës;
- kurrë nuk është vonë për të raportuar dhunën që i ka ndodhur dikujt;
- çfarë do të bëjë SOS Fshati i Fëmijëve që fëmijët të jenë të mbrojtur nga çdo lloj abuzimi, dhe
- çfarë do të bëjë nëse abuzimi ndodh gjithsesi.

Pse kemi nevojë për Politikë për Mbrojtjen e Fëmijëve?

- Çdo fëmijë mund të jetë viktimë e abuzimit ose e neglizhencës dhe është e rëndësishme t'i njeh të drejtat e veta dhe si mund të mbrohet.
- Disa djem dhe vajza janë më shpesh viktimat të abuzimit sepse kanë vështirësi në zhvillim, sepse dallohen nga fëmijët tjerë sipas pamjes, të shprehurit, sjelljes ose sipas diçkaje tjetër.
- Plagët nga abuzimi nuk janë gjithmonë të dukshme, prandaj është e rëndësishme të filloni të flitni për gjërat e vështira dhe të shëmtuara të cilat ndodhin, që ti ndërpresim dhe t'i parandalojmë, kurse pasojat të shërohen që fëmija të jetojë përsëri një jetë të shëndetshme.

A E DINI QË KA FORMA TË NDRYSHME TË ABUZIMIT TË FËMIJËVE? A E DINI SE ÇFARË NËNKUPTOJMË ME FJALËN "NEGLIZHENCË"?

Të rriturit në SOS Fshatin e Fëmijëve duhet me kujdesin më të madh të ruajnë të dhënat për të kaluarën tuaj, historinë e familjes biologjike, gjendjen shëndetësore, shkollimin, sjelljen dhe ngjashëm dhe askujt mos t'ia japin pa dijeninë tuaj dhe pa leje nga prindërit ose kujdestarët tuaj.

ABUZIM FIZIK

Kur një fëmijë i nënshtrohet lëndimit trupor ose dikush dëshiron ta lëndojë fizikisht, atëherë bëhet fjalë për abuzimi fizik.

Abuzim fizik është çdo rrahje, hedhje, helmim, ngufatje, djegie, si dhe dëmtim i qëllimshëm i shëndetit të fëmijës, pavarësisht nëse është bërë nga një i rritur ose një fëmijë tjetër.

Është e rëndësishme të dini se askush nuk ka të drejtë të lëndojë të tjerët, sidomos një më i fortë të lëndojë një më të dobët ose një i rritur të lëndojë fëmijë! Nuk është në rregull as kur prindërit ose të rriturit e tjerë nuk e parandalojnë dhunën që e shohin që u ndodh fëmijëve.

ABUZIM SEKSUAL

Është sjellje me të cilën fëmija detyrohet ose nxitet në akt seksual, kurse kryerësi i abuzimit është një i rritur ose një fëmijë tjetër më i rritur ose më i fortë.

Marrëdhënia seksuale midis një të rrituri dhe një fëmije nuk lejohet - ashtu siç edhe çdo prekje, nxitje ose shfaqje e fotografive dhe filmave të cilat fëmijët i përjetojnë si të pakëndshme, të turpshme ose konfuze. Abuzim seksual mund të kryen një person i panjohur, por gjithashtu është e mundshme të jetë edhe person me të cilin fëmija është i afërt dhe ka besim.

Nëse nuk ju pëlqen se si ju prek dikush ose bile si ju shikon, keni të drejtë të thoni: JO. Mos harroni se ju vet vendosni se kush dhe si mund të ju prek, përqafon, puth.

E drejta jote është që të jesh i/e mbrojtur nga abuzimi seksual.

NEGLIZHENCË

Të rriturit janë të detyruar t'u sigurojnë fëmijëve gjithçka që ata kanë nevojë për rritje dhe zhvillim normal: ushqim, kushte të sigurta jetese dhe kullm mbi kokë, kujdes për shëndetin, për arsimim si dhe për të plotësuar nevojën për dashuri dhe pranim. Kur të rriturit nuk e bëjnë këtë ose janë të pakujdesshëm dhe bëjnë lëshime të mëdha, kjo quhet neglizhencë.

ABUZIM EMOCIONAL

Asnjë i rritur nuk duhet të bëjë që fëmijët të ndjehen të pavlefshëm ose të mos meritojnë të jenë të dashur. Nuk është e drejtë as t'i frikësojnë vazhdimisht fëmijët, të flasin keq për ato ose t'i nënvlerësojnë ato. Askush nuk guxon të kërkojë prej fëmijëve të bëjnë gjëra për të cilat janë ende të vegjël.

DHUNË NDËRMJET MOSHATARËVE

Abuzimi nuk ndodh vetëm mes të rriturve dhe fëmijëve, por edhe ndërmjet vet fëmijëve. Disa fëmijë nuk janë në dijeni se nuk është e drejtë ajo çfarë u bëjnë fëmijët tjerë. Dikush duhet t'u shpjegojë se nuk mund ta bëjnë këtë.

ABUZIM NGA E KALUARA

Abuzimi mund të raportohet edhe më shumë vite pasi ka ndodhur. I rrituri, i cili si fëmijë ose si person i ri në SOS Fshatin e Fëmijëve ka përjetuar abuzim, gjithmonë mund t'i drejtohet dikujt në SOS Fshatin e Fëmijëve i/e cili/a do ta dëgjojë dhe kuptojë.

ÇRREGULLIM I PRIVATËSISË SË FËMIJËS

Të rriturit në SOS Fshatin e Fëmijëve duhet me kujdesin më të madh të ruajnë të dhënat për të kaluarën tuaj, historinë e familjes biologjike, gjendjen shëndetësore, shkollimin, sjelljen dhe ngjashëm dhe askujt mos t'ia japin pa dijeninë tuaj dhe pa leje nga prindërit ose kujdestarët tuaj.

ÇFARË BËN SOS FSHATI I FËMIJËVE PËR TË MBROJTUR FËMIJËT NGA ABUZIMI DHE NEGLIZHENCA:

A KA NDONJË GJË QË DËSHIRON T'UA THUASH TË RRITURVE NË LIDHJE ME MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA ABUZIMI?

Çfarë dëshiron t'u tregojë fëmijëve SOS Fshati i Fëmijëve:

- Ju keni të drejta - kjo përfshin edhe të drejtën për të thënë JO!
- Dhuna nuk lejohet.
- Ne ju dëgjojmë dhe ju kuptojmë seriozisht.

Çfarë dëshiron SOS Fshati i Fëmijëve t'u tregojë njerëzve që jetojnë dhe punojnë me fëmijë:

- Të gjithë njerëzit, sidomos të gjithë fëmijët, duan të jenë të dashur. Kjo na duhet të gjithëve që të jemi në gjendje të ndërtojmë marrëdhënie të mira në jetë. Nuk është abuzim kur fëmija përqafohet në mënyrë plot me dashuri dhe kujdes.
- SOS Fshati i Fëmijëve ju mbështet në ofrimin e kujdesit ndaj fëmijëve në mjedis pa dhunë. Në rast abuzimi të kryer nga fëmijë tjerë, ju nuk jeni të vetëm.
- Të drejtat dhe mirëqenia e fëmijëve janë në radhë të parë. Merrni seriozisht çdo shenjë abuzimi, madje edhe më të voglën, dhe jini bashkë me fëmijët tuaj sa herë që iu nevojiteni.

ÇFARË GJËJE TJETËR DËSHIRONI TË BËHET QË TË NOJHENI MË TË MBROJTUR?

Çfarë duhet të bëhet në rast abuzimi? Ku të drejtohem?

- Nëse ndjeni sikur keni qenë të abuzuar ose keni qenë dëshmitarë kur dikush është abuzuar, duhet t'i tregoni ndonjë personi që i besoni.

A I NJEH TË DREJTAT TUAJA?

Mund të jetë çdo punonjës në SOS Fshatin e fëmijëve.

Pastaj, secili punonjës duhet të raportojë dhunën tek anëtarët e ekipit të sigurimit të fëmijëve në SOS Fshatin e fëmijëve. Edhe ju gjithashtu mund të raportoni tek këta njerëz. Çdo fëmijë dhe çdo i rritur duhet të dijë se kush janë këta njerëz dhe si mund të arrijnë tek ata (ekziston një listë me emrat e tyre dhe është e theksuar në një vend ku të gjithë mund ta shohin).

Ju mund të raportoni drejtpërdrejt dhe mund t'i telefononi në çdo kohë. Gjithashtu mund të raportoni edhe me shkrim - shkruani në një copë letër dhe vendosni në kutinë për ankesa dhe komplimente, dhe mund të dërgoni një mesazh elektronik anonim në aplikacionin për raportimin e dhunës që është në tabelat dhe kompjuterët e shtëpive.

- Nëse keni ndonjë shqetësim, manëtar i këtij ekipi do të bisedojë me ju dhe bashkërisht do të vendosni se çfarë duhet të bëni. Ata do të bisedojnë në lidhje me atë që ka ndodhur vetëm me njerëz që duhet të dinë për ngjarjen, sepse ne kujdesemi gjithashtu edhe për sigurinë tuaj si dhe për mbrojtjen e privatësisë tuaj.

- Ata gjithashtu duhet të jenë të sigurt që ju ose fëmija që është abuzuar të ndiheni më mirë. Ata do të përpiqen t'ju mbrojnë në mënyrën më të mirë që munden nga lëndimet e mëtejshme.

E pra, miq të dashur, ju prezantuar për çka flitet në këtë dokument që e quajmë Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve. Mënyra më e mirë për të parandaluar abuzimin dhe neglizhencën e fëmijëve është të njoheni me të drejtat dhe të dini se çfarë të bëni kur ju ose ndonjë nga miqtë tuaj janë në rrezik për t'u lënduar. Do të dëshironim t'ju inkurajojmë që të flisni hapur për mbrojtjen e fëmijëve – bile edhe kur është vështirë për të folur. Kjo do t'ju ndihmojë të rriturve të kuptojnë më mirë atë që ju nevojitet që ju të ndiheni të sigurt dhe t'u mbrojnë më mirë.

Ju faleminderit!